



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 797/Prot.
1

Tiranë, më 16 / 6 / 2017

VENDIM

Nr. 82, datë 16 / 6 / 2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "BIRN Albania", përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 797 Prot., datë 12.05.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ministria e Drejtësisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet shkresës së datës 21.04.2017, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Kopje të kontrolleve (inspektimeve) të planifikuara dhe të ushtruara në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Mat, Lezhë dhe Pogradec, me objekt "verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së gjithë prokurorëve të këtyre prokurorive në procedimet penale të mosfilluara dhe procedimet penale të përfunduara me vendim pushimi, të hetuara prej tyre për një periudhë 1 vjeçare dhe 18 mujore" gjatë periudhës 01.03.2015-01.03.2016.*
2. *Kopje të kontrolleve (inspektimeve) mbi bazë ankese, që janë ushtruar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Vlorë, Kavajë, Elbasan, Korçë, me objekt "verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit gjatë trajtimit të kallëzimeve/procedimeve të veçanta", gjatë periudhës 01.03.2015-01.03.2016.*
3. *Rekomandimet dërguar Prokurorit të Përgjithshëm për fillim të procedimit disiplinor për 12 prokurorë, veprimtaria e të cilëve është konstatuar me shkelje të detyrës gjatë periudhës 01.03.2015-01.03.2016, nga të cilët 1 Prokuror i Prokurorisë së Rrethit Mat, 10 prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Lezhë dhe 1 prokuror i Prokurorisë së Rrethit Pogradec.*

4. *Përgjigjet e marra nga Prokurori i Përgjithshëm në lidhje me rekomandimet për procedim disiplinor gjatë periudhës 01.03.2015-01.03.2016.*

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. Q-25/3 Prot., datë 09.05.2017 duke e vënë në dijeni se të dhënat për inspektimet e kryera dhe rekomandimet rreth tyre për Prokurorin e Përgjithshëm, janë të përfshira në Raportin Vjetor që Ministri i Drejtësisë ka paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë si dhe duke i vënë në dispozicion linkun ku mund të njihet me informacionin e kërkuar në përputhje me nenin 16 pika 2 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Lidhur me përgjigjet e Prokurorit të Përgjithshëm për rekomandimet për procedim disiplinor, Autoriteti Publik është shprehur se në bazë të nenit 17, pika 2/ ç) të Ligjit për të Drejtën e Informimit, ky informacion lidhet me ecurinë e procedimit/eve disiplinore, për të cilat organi kompetent për dhënien e tij është Prokurori i Përgjithshëm.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 797 Prot., datë 12.05.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me anë të komunikimit elektronik, me datë 15.05.2017 i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 19.05.2017.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik ka kthyer përgjigje me datë 17.05.2017 nëpërmjet emailit duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në shkresën e sipërpërmendur dhe duke përcjellë bashkëlidhur një kopje të Raportit të Ministrisë së Drejtësisë, me pretendimin se në të përfshihen të dhënat për inspektimet e kryera dhe rekomandimet rreth tyre për Prokurorin e Përgjithshëm.

Kërkuari ka vazhduar ankimin duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumenteve të kërkuara dhe jo përmbledhjen e të dhënave të tyre në një raport për parlamentin.

Autoriteti Publik e arsyeton refuzimin për vënien në dispozicion të akteve të inspektimit me faktin se aktet individuale të kontroleve të kryera përgjatë periudhës së raportimit, përmbajnë të dhëna personale dhe të dhëna gjyqësore të shtetasve të përfshirë në procedime që lidhen me hetimin dhe ndjekjen e veprave penale publikimi i të cilave kufizohet në nenin 17, pika 1, gërma a), pika 2, gërma b), c) dhe dh), si dhe në nenin 27 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i ankimit dhe konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “BIRN Albania” në pikat 1, 2 dhe 3 të kërkesës për informim, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Lidhur me pikën 4 të kërkesës për informacion, bazuar në pikën 2 të nenit 12, të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, *Autoriteti Publik në qoftë se konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.*

Pra, Autoriteti Publik, nëse nuk e zotëron informacionin e kërkuar në këtë pikë, duhej të kishte proceduar ai vetë me përcjelljen e kërkesës pranë Prokurorit të Përgjithshëm duke vënë në dijeni për këtë fakt dhe kërkuuesin, dhe jo të adresonte këtë fundit për t’iu drejtuar me kërkesë të posaçme Prokurorit të Përgjithshëm.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kufizimet e përcaktuara në nenin 17, pika 1, germa a) dhe pika 2, germa b), c) dhe dh) të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe që lidhen përkatësisht me cënimin e të drejtës për një jetë private, cënimin e proceseve të parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale, ecurinë e hetimeve administrative në kuadër të procedimit/eve disiplinore dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar.

Rrjedhimisht personat përgjegjës duhet ta vënë atë në dispozicion të kërkuuesit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Pra, me qëllim përmbushjen e kërkesës për informacion, Autoriteti Publik duhet të kryejë anonimizimin e të dhënave personale dhe gjyqësore të shtetasve të përfshirë në procedimet objekt inspektimi, si dhe duke fshirë ato pjesë të dokumentacionit të kërkuar të cilat i nënshtrohen kufizimeve të mësipërme.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendres “BIRN Albania”, përfaqësuar nga Z.

kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 797 Prot., datë 12.05.2017 të Qendrës "BIRN Albania", përfaqësuar nga Z. _____, ndaj Autoritetit Publik "Ministria e Drejtësisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informim datë 21.04.2017 në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", brenda datës 27. 6 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 16. 6 .2017.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI